

AKT THEMELIMI DHE STATUT “LOAN” SHPK

AKTI I THEMELIMIT DHE STATUTI

I

SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR “LOAN” sh.p.k.



AKT THEMELIMI DHE STATUT “LOAN” SHPK

Kreu I

THEMELIMI, EMRI, OBJEKTI, KOHËZGJATJA, SELIA

Neni 1

Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesit

Bazuar në Kushtetutë dhe Kodin Civil në fuqi të Republikës së Shqipërisë, ligjin nr.9901 date 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare” dhe në ligjin nr. 9723, date 3.5.2007 për Q.K.B (Qëndra Kombëtare e Biznesit):

1. Sot më date 13/07/2023 une,

- **Arnold Imeri** shtetas Shqiptar, lindur me 18/06/1994, banues Tirane , Vore , identifikuar me numrin e kartes se identitetit nr **J40618099D** vendosa per te kriuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin **“LOAN” SH.P.K.**

Neni 2

Objekti

Shoqëria do të kryejë aktivitetin e mëposhtëm:

- Riparime ndertimi
- ndertim pishina dhe te ngjashme
- restaurime ndaj te treteve

Neni 3

Kohëzgjatja

Jetëgjatësia e shoqërisë do të jetë me afat të pacaktuar.

Neni 4:

Selia

1.Selia e shoqërisë ndodhet ne adresën: Rruga Kodra Xhirajt Marqinet / Vore/Tirane , zk 2605 , nr 200/6/1



AKT THEMELIMI DHE STATUT “LOAN” SHPK

(1) Adresa e shoqërisë për qëllime komunikimi elektronik është si vijon:
imeriarnold@gmail.com

KREU II

KAPITALI

Neni 5

Kapitali themeltar

- (1) Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është **500.000** Lekë.
- (2) Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme:
- a. Ortaku I vetem Z Arnold Imeri : Zotëruese i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme që përbën **100%** të kapitalit themeltar të shoqërisë (500.000 Leke)

Kontributi I ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë(pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta)

Neni 6:

Zmadhimi dhe zvogëlimi I kapitalit

Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar pér kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nepermjet emërimit nga gjykata kompetente e një eksperti të autoriazuar per këto kontribute sipas kërkesës së administratorit.

Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak pér të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.

Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakëve, e cila merr vendimin në të njëjtat kushte që kërkohen pér ndryshimin e statutit.

Në të gjitha rastet zvogëlimi i prek ortakët në të njëjtën mase ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.

AKT THEMELIMI DHE STATUT “LOAN” SHPK

Neni 7

Transferimi I kapitalit

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) Kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) Shitblerjes;
- c) Trashëgimisë;
- d) Dhurimit;
- e) Cdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht te transferueshme ndërmjet ortakëve, për sa nuk parashikohet ndryshe ne statut.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

Kreu III

ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

Neni 8


Organi vendimmarrës

Ortaku i shoqerise eshte organi i vetem vendimmarres i shoqërisë.

Ortaku i shoqerise eshte organi i vetem vendimmarres i shoqërisë që miraton cdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.

Ortaku eshte përgjegjës për marrjen e vendimeve për shoqërime për çeshtjet e mëposhtme:

- a) Përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) Ndryshimet e statutit;
- c) Emerimin e shkarkimin e administratorëve;
- d) Emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- e) Percaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat “c” dhe “d” të kësaj pike;
- f) Mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së verimtarisë;
- g) Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- h) Zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;



AKT THEMELIMI DHE STATUT “LOAN” SHPK

- i) Pjesetimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- j) Përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe ne proçedimet e tjera ndaj administratorëve;
- k) Riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- l) Miratimin e rregullave proceduriale të mbledhjeve të asamblesë;
- m) Ceshtje të tjera të parashikuara nga ligji apo statute.

Cdo ndryshim i statutit rregjistrohet sipas ligjit ne Qendren Kombetare te Biznesit.

Neni 9 Administrimi

(1) Ortaket emërojne një ose më shumë persona fizik si administrator të shoqerisë. Afati i emërimit është 5 vjet, me të drejtë ripërtëritje. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas rregjistrimit ne Qëndrën Kombëtare të Regjistrimit.

(2) Administratorët e një shoqërie tregtare mëmë, sipas përcaktimit të nenit 207 të këtij ligji, nuk mund të emërohen si administrator të një shoqërie të kontrolluar e anasjelltas. Cdo emërim i bërë në kundërshtim me këto dispozita është i pavlefshëm.

(3) Personi i mëposhtëm caktohet si Administrator i parë i shoqërisë deri në emërimin ë tyre nga mbledhja e parë e Asamblesë së Përgjithshme.

Të dhënat e identifikimit:

Z. Arnold Imeri shtetas Shqipetar, lindur me 18/06/1994, banues Tirane , Vore , identifikuar me numrin e kartes se identitetit nr **J40618099D**

Neni 10 Kompetencat e Administratorëve

Administratorët kanë të drejtë e detyrohen të:

- a) Kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tragtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- Përfaqësojnë shoqërinë tregtare;



AKT THEMELIMI DHE STATUT “LOAN” SHPK

- Kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabel të shoqërisë;
- Përgatisin dhe nënshkruajë bilancin vjetor,bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe,së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve,l paraqesin keto dokumente perpara asamblese së përgjithshme për miratim;
- Krijonjë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat,që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- Kryejnë rregjistrimet dhe dérgojnë të dhénat e detyrueshme të shoqërisë,siç parashikohet në ligjin për Qëndrën Kombëtare të Regjistrimit;
- Raportojnë përparrë asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare,dhe me realizimin e veprimeve te posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- Kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.
- Administratoret janë të detyruar të thërrasin asamblene e përgjithshme në rastet kur:
- Sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare,rezulton ose ekziston rreziku që aktivitetet e shoqërisë nuk I mbulojnë detyrimet e kërkueshme brënda 3 muajve në vazhdim.
- Shoqëria propozon të shesë apo të disponojë një mënyrë tjetër active,të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5% të aseteve të shoqërisë,që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara..

Nëse asambleja e përgjithshme emëron më shumë se 1 administrator ,ata e administrojnë bashkarisht shoqërinë.

Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në cdo kohë me shumicë të zakonshme.Paditë që lidhen me shpqrblimin e administratorit ,në bazë të mardhënieve kontraktore me shoqërinë,rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Neni 11 Përgjegjësité e Administratorit

Administratori është përgjegjës individualisht,ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve,për shkelje të ligjeve,për shkëlje të statutit,apo për faje te kryera gjatë administrimit të shoqërisë.Pasojet e marrëveshjeve te pamiratuara nga asambleja që I sjellin dëm shoqërisë,l ngarkohen administratorit dhe ortakut qe ka bërë marrveshjen,për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht,sipas rastit,pasojet përkatëse

AKT THEMELIMI DHE STATUT "LOAN" SHPK

Perveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë,sipas neneve 14,15,17 e 18 të ligjit "Për tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare",administrator detyrohet;

1.

- a) Të kryejë detyrat e tij të përcaktuara ne ligj dhe ne statut në mirëbesimin dhe interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi,duke l kushtuar vëmëndje të veçante ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjesid;
- b) Te ushtrojë kompetencatqë l njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
- c) Të vlerësojë me përgjegjësi çeshtjet,për të cilat merret vendimi;
- d) Të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit,present apo të mundshëm,të interesave personale me ata të shoqërisë;
- e) Të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizëm dhe kujdesin e nevojshëm.

2.Administratori,gjatë kryerjes së detyrave të tij,përgjigjen ndaj shoqërisë për cdo veprim apo mosveprim,që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare,me përjashtim të rasteve kur,në bazë të hetimit dhe vlersimit të informacioneve përkatëse,veprimi ose mosveprimi është kryer ne mirëbesim.

3.Nëse administrator vepron ne kundershtim me detyrat dhe shkel standartet profesionale,sipas pikave 1 e 2 të këtij nenit,është l detyruar t'l dëmshpérblejë shoqërisë dëmet,që rrjedhin nga kryerja e shkeljes,si dhe ti kaloje çdo fitim personal që ata apo pësonat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta.Administratori ka barren e proves për të vertetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkua.Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator,ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.

4.Në mënyrë të veçantë por pa u kufizuar në to,administrator është l detyruar ti dëmshpérblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara,nëse,në kundërshtim me dispozitat e ligjit "Për tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare",kryen veprimet e mëposhtme;

- a) U kthen ortakëve kontributet
- b) U paguan ortakëve interest apo dividentë;
- c) U shpérndanë aktivet shoqërisë;
- d) Lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare,kur,në bazë të gjëndjës financiare,duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishtë aftësi paguese për të shlyer detyrimet;
- e) Jep kredi.

Përveç padisë për shlyerjen e dëmit që l ngarkohet personalisht administrator,ortakët individualisht ose së bashku,kanë të drejtë të ngrenë padi penale kundër administratorit.

AKT THEMELIMI DHE STATUT “LOAN” SHPK

Paditësit kanë të drejtë të ndjekin në rrugë ligjore shlyerjen e plotë të dëmit që i është shkatuar shoqërisë, përfshirë edhe dëmshpërblimin financiar, nëse është e nevojshme. Asnjë vendim i asamblesë nuk mund të ndalojë ngritjen e kërkesë padisë kundër administratorit për gabimet e kryera prej tij gjate ushtrimit të detyrës

Kreu IV VITI FINANCIAR-EKSPERTET

Neni 12

Viti finanziar

Viti finanziar i shoqërisë fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor. Përjashtimisht viti i parë fillon nga data e rregjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit dhe mbyllt me 31 Dhjetor.

Neni 13

Ekspertët

Eksperti ka për detyrë që të kontrollojë të gjithe dokumentacionin kontabël të veprimtarisë ekonomiko-tregtare të shoqërisë, atë gjithvjetor dhe atë në lidhje me kontrollet periodike te ushtruara prej tij, përrastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë te tillë I ngarkuar nga ana e ortakëve.

Në përfundim të kontrollit eksperti kontabël i autorizuar përgatit raportin me shkrim për nxjerrjen e rezultatit të bilancit finanziar vjetor si dhe atë për kontrollet periodike te ushtruara të cilat është I detyruar, qe t'ja paraqesë e dorëzojë në kohë ortakëve, për t'l shqyrta e miratuar mbi bazën e të drejtës vendore që ka.

KREU V PRISHJA-RIORGANIZIMI I SHOQËRISE

Neni 14

Prishja dhe likuidimi

Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të bëhet në çdo kohë:

- Kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- Me vendim të asamblesë së ortakëve;
- Me hapjen e procedurave të falimentimit;
- Nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi I veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, date 03.05.2007 “Për Qëndrën Kombëtare të Regjistrimit”

AKT THEMELIMI DHE STATUT “LOAN” SHPK

e) Me vendim të gjykates;

Në këtë rast ortakët marrin vendim me shkrim në të cilin parashikojnë, mënyrën e likujdimit të shoqërisë, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shënuar në cdo document të nxjerrë prej tij emrin e likuidatorit dhe emërtesën shtesë “Shoqëri në likuidim e sipër”

Prishja e shoqërive tregtare ka sipasojë hapjen e procedurave të likujdimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedure falimentimi. Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga oratkët.

Nëse oratkët nuk marrin një vendim për emërimin e likuiduesve, brënda 30 ditëve pas prishjes, cdo person i interesuar mund ti drejtohet gjykates, për të caktuar një likuidues.

Neni 15

Riorganizimi i shoqërisë bashkimi-ndarja

Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vendimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara ne pjesen IX te Ligji 9901 date 14.04.2012 “Për tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”.

Neni 16

Baza Ligjore

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e tij në përputhje të plotë me këtë statut dhe dispozitat e legjislacionit Shqiptar.

Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit “Për tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, Kodit Civil dhe cfarëdo ligji tjeter specific ne Republikën e Shqiperisë.


Neni 17

Mosmarrveshjet

Për mosmarrveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarrveshje që mund të lindë midis shoqërisë dhe të tretëve, do të jetë kompetente Gjykata Shqiptare.

ORTAKU I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

Z. Arnold Imeri


(nënshkrimi)

AKT THEMELIMI DHE STATUT “LOAN” SHPK
